

## PËRJETËSIA E GJUHËS SHQIPE QË NGA FILLIMI

Saimir A. Lolja

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Blvd. Zogu I, Tiranë 1001, Shqipëri

### Përmbledhje

Në fillim, njeriu ka një gjuhë dhe pastaj e len...gjuhën ose jo. Gjuhë natyrore shqip domethënë të përdorësh gjuhën në gojë për të shqiptuar fjalët. Përjetësia e Shqipes (*Speech*, ang.) gjuhës shqipe qëndron tek fjalët e saja që janë në vetvete shprehje fjalore, pjesë fjalisë ose fjali të shkurtra. Edhe gjuha shqipe edhe ato jo-shqipe ose len...gjuhët (*lan...guages*, ang.) i mbartin këto lloj shprehjesh fjalore, duke vërtetuar kështu përjetësinë natyrore të Gjuhës Shqipe.

Shqipja (*The Speech*, ang.) ka patur të folura e të shkrojtura vendore dhe shkollore në lashtësinë e tej largët. Prandaj forma të ndryshme të shkrimit të Shqipes ndeshen tani. Forma shkollore, ngase ka qenë në përdorim të përgjithshëm dhe më pas është mbartur në shkrimet dhe librat e len...gjuhëve, është ruajtur e pandryshuar. Copëzat e saja sado të vogla lexohen lehtë dhe kuptohen menjëherë nëpërmjet Shqipes së sotme.

Shqipja (*The Speech*, ang.) ishte shtresa e parë në hapësirën Euro-Mesdhetare. Ajo ishte Shqipja e Nëfillimëve (*The Speech of Nephilims*, ang.). Shqipja e sotme mund të përdoret për të lexuar dhe kuptuar edhe fjalët në gjuhët e tjera edhe shkrimet e lashta.

Fjalët kyç: Gjuhë, Nëfillim, *Speech*, Shqip, *Albanian*, Pellazgët, Arbëresh

### 1. Hyrje

Tek e vërteta shkohet me fakte të lidhura dhe arsye, sepse faktet vetëm nuk mjaftojnë. Akoma më shumë faktet nga e shkuara humbin vlerë kur me qëllim iu mvishet një lexim apo kuptim i caktuar. Prandaj gërmimi për dije kërkon logjikën shkencore si mjet për qëllim. Një e vërtetë logjike është një pohim i cili mbetet i vërtetë nën të gjitha këndvështrimet dhe vërtetohet vetëm në mënyrë natyrale. Sipas mendimit të gjithanshëm *Gottfried Wilhelm Leibniz* (1646-1716), e vërteta që rrjedh prej arsytimit dhe shpjegimit i saj zbulohet nga shqyrtimi i pjesëve dhe ideve gjithnjë e më të vogla derisa të shkohet në rrënjën e fjalës ose çështjes nën studim. [1, 2]

Shqipja (*The Speech*, ang.) pasaktësisht njihet si “*Albanian lan...guage*” në vend të “*Albanian tongue*” në anglisht. Ajo që trashëgohet në lidhje me shqiptarët dhe shqipen (*speech*, ang.) është një errësirë në dije, kuptim dhe përfytyrim të së shkuarës. Paqartësia fillon me preken që shqipfolësit e quajnë veten shqiptarë kurse të huajt i quajnë ata *Albanians*. Errësira shtohet më shumë edhe nga hutimi që sjell rryma mbizotëruese e shpjegimit të së shkuarës së largët vetëm me lëvizje populatash pushtuese të cilat e shfarosin popullatën vendase, mohim të atyre vendase, paragjykim të lashtësisë si një periudhë kur mungonte zhvillimi, dhe shtjellim të çdo gjëje apo sendi të lashtë vetëm nga pikëpamja fetare. Prandaj, çështja nuk është nëse ka patur shqip e shqiptarë në të shkuarën apo jo. Çështja është se të shkuarës së largët nuk i kanë rënë rrezet e dritës në mënyrë të plotë dhe kjo nënkupton domosdoshmërinë me e ndriçuar të shkuarën shqiptare, europiane e mesdhetare.

Prandaj, qëllimi i këtij kërkimi është të hetojë nëpërmjet prekjeve, arsytimeve, dhe krahasimeve shtrirjen e Shqipes (*Speech*, ang.) në të shkuarën. Meqenëse ky studim analizon Shqipen shumë thellë në kohën e shkuar, rrugëtimi shkencor do jetë jo i zakonshëm. Hetimi fillon me Kohët e Errësirës dhe

lindjen e gjuhës Bizantine. Analiza në këtë studim përdor themelet shkencore të shkencës së Gjuhësisë (*Lin...Guistics*, ang.), Shqipen e sotme, librat e shenjtë të vjetër, emërtimet e vendeve, dhe gjuhët Latine, Bizantine dhe Anglishte.

## 2. Kohët e errësirës

Errësira parë ishte ajo e shekujve V – XV, e cila mbuloi Europën dhe filloi me botimin e librit *Mythologiae* në latinisht nga autori Fabius Planciades Fulgentius në shekullin V e.s. [3]. Errësira filloi me prishjen e tërë shkollave dhe universiteteve romake dhe zhdukjen e tërë librave dhe bibliotekave. Domethënë errësira filloi me Marrëveshjen e Milanos në vitin 313 për ta shndërruar perandorinë romake në perandoritë fetare të krishtera të Perëndimit dhe të Lindjes, ku pati vetëm manastire e kisha. Ajo perëndimore vazhdoi deri në vitin 476, kurse ajo lindore deri në vitin 1453. Ndër manastire qëndronin murgjërit të cilët ishin të vetmit që dinin shkrim e këndim. Ndarja e perandorisë romake në atë të lindjes dhe perëndimit, si dhe mbarimi i asaj perëndimore, e shtuan errësirën akoma më shumë.

Përkthimet e fjalës *Mythologiae* janë: *Mythologiae* (lat.) = *The Science of Lie* (ang.) = Shkenca e Gënjeshtërs (shqip). Ay libër që burimi kryesor i murgjëve për fshirjen e kujtesës së përbashkët për historinë e shkuar të afërt dhe për të ushqyer mendjet me përfytyrimin e pasaktë të lashtësisë. Në kisha priftërinjtë udhëzonin turmat e popullatave të pashkolluara çfarë të dinin e si të mendonin vetëm me rrëfime nga Dhiata. Për çdo xixë mendimi ndryshe Inkuizicioni i shekujve XII-XIX e dënonte njeriun me tortura dhe djegie në turrën e druve.

Për të freskuar Shkencën e Gënjeshtërs në kushtet e Rilindjes Europiane që pat filluar t'i ndizen dritëzat që në shekullin XIV, autori italian Natalis Comes boton në vitin 1567 në Venecie librin me dhjetë vëllime me të njëjtin titull *Mythologiae*. [4] Të njëjtin shërbim kreu edhe ky libër i cili që nga ajo kohë u bë burimi Mitologjisë (alb.) klasike, e thënë shqip, burimi i zbatimit të Shkencës së Gënjeshtërs për të fshirë kujtesën e përbashkët të saktë të breznive të reja mbi lashtësinë dhe për ta zëvendësuar atë me një përfytyrim të pasaktë.

Pati kohë të mjaftueshme në Errësirë e shekujve V – XV me djegur libra, shkolla e biblioteka, me fshirë kujtesën popullore e shkollore, me rrafshuar qytete, kështjella, rrugë e qytetërime, me mbuluar me dhe vende e gjurmë, me shfarosur numër të madh njerëzish, me ndryshuar emrat e njerëzve dhe emërtimeve gjeografike. Dhe njëkohësisht pati kohë të tepërt me shpikur disa libra të paktë ose me rishkrojtur shumë herë sipas dëshirës ca libra të tjerë, e gjithmonë me natyrë fetare.

Errësira e dytë ishte ajo e shekujve XV - XIX, e cila mbuloi Gadishullin Ilirik të pushtuar nga perandoria osmane. Ajo vazhdoi për inerci mbi trojet shqiptare në shekullin XX dhe u shtua prej errësirës sllavo-barbare. Prandaj, Errësira e dytë në shekujt XV-XX që pllakosi trojet shqiptare ose ruajti cipën e trashë të errësimit bizantin ose e trashi atë me cipat e saja osmane-arabe dhe sllavo-barabare. Çfar kishte mbetur pa u sheshuar me tokën apo pa u djegur u plotësua në Errësirën e dytë. Gjithashtu, shtrembërimi në përfytyrim i së shkuarës u edukua në shekullin XX. Shekulli XXI është shekulli i zgjimit dhe ndriçimit të mendjes shqiptare.

## 3. Një ngatërresë lindore në përfytyrim

Perandoria romake, zyrtarisht e filluar në vitin 27 p.e.s., pati latinishten si len...gjuhë të bashkimit dhe ndërlidhjes. Perandoria romake kishtare perëndimore dhe pas vitit 476 e.s. kishat perëndimore ruajtën latinishten për librat fetarë, që gjithashtu ishin të vetmit që lejoheshin në qarkullim.

Priftërinjtë bizantinë vëllezër Cyril dhe Methodius rithurën në vitin 863 Abecenë Glagolitike. [5] Ajo, duke u përshtatur në kohë dhe hapësirë, u fut në përdorim e mori forma të ndryshme në kishat lindore. Perandoria romake kishtare lindore u nda përfundimisht nga ajo perëndimore në vitin 1054 dhe e ndërpreu plotësisht përdorimin e latinishtes.

Patriarkana e krishterë ortodokse në Qytetin e Konstandinit (Stambolli i sotëm) e ndërtoi len...gjuhën e vet bizantine mbështetur edhe në gërma para latine të rajonit të Detit Mesdhe; më së shumti prej shtresës ilirike. [5] Gjithashtu, ndërsa fjalët latine në Perëndim përdornin prapashtesën -us, len...gjuha Bizantine në Lindje i dalloi fjalët e saja me prapashtesën -os. Duke u dalluar plotësisht nga latinishtja e Perëndimit, ajo u bë len...gjuha zyrtare kryesore e perandorisë romake fetare lindore. Kjo perandori vazhdoi deri në vitin 1453.

Në vitin 1830, perandoritë e Britanisë, Francës e Ruisë krijuan principatën fetare të njohur me emrin “Greqi”, me sipërfaqe sa 1/6 e Greqisë së sotme. Si për një shtet fetar, në thelb si për një shëmbëlltë të ish-perandorisë së krishterë lindore, Patriarkana e krishterë ortodokse në Stamboll caktoi që len...gjuha zyrtare e “Greqisë” të ishte ajo bizantine e vetë Patriarkanës.

Si flamur për shtetin fetar “Greqi”, perandoria britanike zgjodhi flamurin e vitit 1700 të sipërmarrjes së madhe tregtare “*British East India Company*”. Sepse ay flamur e kishte kryqin për principatën fetare “greke” dhe vetëm ngjyra u ndryshua nga e kuqe në blu. [6]

Si rrjedhim, dhe për shkak të propagandës nga tifozët e dëshiruar të një “Greqie” të lashtë, ndodhi dhe ngatërresa mendore: ngase shteti u quajt “Greqi”, len...gjuha zyrtare në të u quajt gabimisht “greqisht”. Dhe qëllimisht dhe gabimisht tifozët e dëshiruar të një “Greqie” të lashtë dhe të vetëquajturit “grekë”, duke u kthyer mbrapsht në kohë, quajtën e quajnë “greke” tërë perandorinë romake lindore dhe tërë historinë para-romake.

Priftërinjtë e krishterë ortodoksë në Lindje qenë shkruesit, folësit, përhapësit dhe mësuesit e len...gjuhëve të reja për popullatat që zotëronin. Në “Greqi”, gjuha e popullit ishte ndryshe nga ajo e kishës. Popullata ishte arbanase, arbanite (arvanite, biz.) dhe gjuha e saj ishte shqipja. Edhe tani popullata vendase, veçanërisht të moshuarit, flasin shqip. Edhe nën sundimin e perandorisë romakë fetare lindore edhe në atë të perandorisë osmane banorët në atë që quhet sot “Greqi” flitnin shqip dhe e quanin veten ose i quanin romakë, romanë, romaiot ose romiot. Veçse propaganda nga perandoritë europiane në shekullin XIX krijoi përrallën e një “Greqie të lashtë të populluar nga njerëz të bukur, të gjatë, flokëverdhtë, të urtë, që përfaqësonin përsosmërinë”. Dhe ia veshi atë përrallë “greke të lashtë” popullatës vendase shqiptare duke e quajtur atë popullatë “greke”. [7]

Domethënë, komb "grek" apo "helen" nuk ka, nuk ka patur ndonjëherë. Po të lexohet historia e shkruar dhe të vështrohen hartat e shkuara nuk ndeshet që të ketë patur ndonjëherë shtet “Greqi” e “grekë” apo “Hellas” e “helenë” apo ndonjë lloj perandorie “greke” e perandorë “grekë”. Në tërë periudhën e Republikës apo Perandorisë Romake nuk ka patur ndonjë provincë ose rajon me emrin “Greqi” apo “Elláda”. Në to ndeshen emrat *Illyria, Prefecture of Illyricum, Macedonia* dhe *Epirus*, por jo “Greqi” apo “Elláda”. [8]

Vetëm në periudhën fundshekulli VII – fundshekulli XII qe një provincë e perandorisë romake lindore që quhej *Theme of Hellas* (ang.) e cila qarkonte disa copëza të Greqisë së sotme. Emërtimi qe i rastësishëm, vetëm për qëllime luftarake perandorake kundër dyndjeve sllave, dhe pa lidhje kulturore e gjuhësore me vendasit Arbanas – Arbanitë – Arvanitë – Shqiptarë. [9]

Perandoria romake lindore e krishterë qe perandori romake e krishterë ortodokse dhe jo “greke”. Perandorët e saj qenë nga vende të ndryshme, p.sh. Iliria, Siria, Bullgaria, etj. Në qofte se do ishte krijuar një shtet me len...gjuhën perandorake latine, atëherë a do te quhej ai komb latin me len...gjuhë kombëtare latine?

Gjithashtu për nga emri, nuk ka patur, për shembull, Itali, Shqipëri, Gjermani, Francë, Turqi ose Egjipt të lashtë. Vendet dhe popullatat kanë qenë organizuar ndryshe dhe emrat e tyre kanë qenë ndryshe. Edhe Egjipti i sotëm në lashtësi quhej Nubia. Atëherë, pse duhet të ketë “Greqi të lashtë”?!

Në dy shekujt e kaluar, shumë shkrime të lashta të gdhendura mbi gur dhe poçe janë mëtuar se përfaqësojnë gjuhën “greke të lashtë”. Gjuha Bizantine, domethënë gjuha greke e sotme, nuk ndihmon për të lexuar, shqiptuar dhe kuptuar gjuhën e dëshiruar “greke të lashtë”. Format, qëllimet, dhe renditja e fjalëve (domethënë, gramatika e saj) dhe formimi i shprehjeve e fjalive (domethënë, sintaksa e saj) të “greqishtes së lashtë” janë të pakuptimta për greqisht-folësit e sotëm, pavarësisht se disa germa mund të duken të ngjashme.

#### 4. Gjuhësia si shkencë

Dëshmia për vjetërsinë e një të folure të shkruar janë ose shkrimet e ngurta ose librat e vjetër. Gjuhësia si shkencë filloi në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Si në shkencat e tjera, cilësia e kërkimeve shkencore në gjuhësi varet nga vërtetësia e matjeve eksperimentale, cilësia e mjeteve matëse, këndvështrimi dhe qëllimi i tyre.

Shtyllat kryesore të gjuhësisë si shkencë janë: Gramatika – rregullat e ndërtimit të rrënjës së fjalisë, shprehjeve e fjalëve; Morfologjia – rrënjët, pjesët e fjalëve, dhe marrëdhëniet ndërmjet fjalëve; Sintaksa – parimet e ndërtimit të fjalisë; Fonologjia – organizimi i tingujve; Fonetika – lidhja tingullshenjë; Semantika – kuptimi i pranuar për shprehjet, fjalët e shenjat; Pragmatika – lidhja përmbajtje-kuptim, përçimi i kuptimit; Antropologjia – gjuha si nevojë e shoqërisë dhe pjesë e kulturës.

#### 5. Në fillim ke gjuhën pastaj e len...gjuhën ose jo

Në fillim njerëzit patën një gjuhë. Më pas, disa e mbajtën e disa jo. E folura kryhet fizikisht nëpërmjet gjuhës (*sermone*, lat.; *tongue*, ang.; *sprache*, gjer.) që njeriu ka në gojë. Prandaj në shqip thuhet “Ai flet gjuhën...”. Domethënë, ai flet sipas gjuhës ose shqipton duke përdorur gjuhën e programuar nga natyra për atë qëllim. Dhe, ai që e ka lënë...gjuhën (*lin...gua*, lat.; *lan...guage*, ang.) flet lin...gjuhën ose len...gjuhën. Domethënë duhet ta kesh gjuhën në fillim dhe pastaj e len...gjuhën ose jo.

Ky është vërtetim se gjuha shqipe ka qenë ose ka mbirë para len...gjuhëve të tjera. E thënë me një shembull, në fillim kanë qenë emrat shqip Gjon e Gjergj dhe pastaj kanë dalë emrat jo-shqip *Giánnis* e *Geórgios* ose *John* e *George*. Sepse, përndryshe do të ishin në shqip edhe emrat Gjon e Gjergj edhe emrat *Janis* e *Jorgios* edhe *Xhon* e *Xhorxh*.

Kjo përputhet edhe me përfundimin e pranuar nga Prof. Luigi Luca Cavalli-Sforza në librin e tij “Gjenet, Popujt dhe Gjuhët”. Aty, në Figurën 13, faqe 164, Shqipja (*Speech*, ang.) është gjuha më e vjetër me moshë mbi 9000 vjet, domethënë si e para gjuhë e mbirë krahasuar me len...gjuhët e tjera të grupuara në modelin e të folurave Euro-Indiane; luteni të shihni Figurën 1. [10]

Periudha akullnajore në Europë llogaritet 25’000-13’000 vite më parë. Gjetjet arkeologjike kanë treguar se pas saj jeta filloi të rigjallërohet. Rreth 10’000 vite më parë njerëzit filluan të merren me bujqësi, domethënë pjell-ar-gët, tokarët, ar-bërë-sit, arbëreshët ose ar-bana-sit filluan ta rikthejnë tokën në arë bujqësore. Akoma në shqipen e sotme, ai që merret për të punuar arën (tokën bujqësore) quhet “argat”. E vërtetë sepse kultura kombëtare, ku bën pjesë edhe e folura edhe arti i veshjes, trashëgohet gjenetikisht. [10] Kurse fjala shqipe “pjellargët” është futur në përdorim e lexuar jo-saktë si “pellazgët” (*pelasgians*, ang.) prej autorëve jo shqiptarë.

Të folurat janë si lulet e jetës që mbijnë mbi një shtresë të vetme ose të përbashkët. Ky këndvështrim është në harmoni me urtësinë e lashtë të Lules së Jetës mbi Tokë. Nga pikëpamja gjeometrike, Lulja e Jetës jep harmoni të plotë të përpjesëtimeve që përmban. Nga ajo dalin Pema e Jetës, Veza e Jetës, Fara e Jetës, Fruti i Jetës, sfera, trupat e ngurtë Platonikë, thyesa e artë e numrave, gjeometria e shenjtë, etj. [11] E shpjeguar me një shembull të ngjashëm natyror, lulja *Narcissus poeticus* futet shkencërisht brenda familjes *Amaryllis* të luleve dhe kjo nuk domethënë se *Narcissus poeticus* ka lindur nga, bie fjala, *Amaryllis belladonna*.




Figura 1. Pema e gjuhëve. [10]

## 6. Mbartur në gjuhën e vet

Dy mijëvjeçarët e fundit të pushtimit të trojeve arbërorë nga perandoritë romake dhe osmane qenë të mjaftë për të mbuluar ose fshirë pothuaj çdo gjurmë të dukshme të shqipes së shkruar ose të skalitur. Megjithatë gjuha shqipe ka një veti që e bën atë të përjetshme, sado pak të dallohet diku. Edhe në të

folurën e të shkrojturën e sotme, Shqipja (*The Speech*, ang.) përmban shumë fjalë që në vetvete janë pjesë fjalie me kuptim të qartë gramatike, morfologjik, sintaksor, fonologjik, fonetik, semantik, pragmatik e antropologjik. Vetëm një që është shqiptar i lindur mund t'i dallojë ato fjalë lehtësisht. Ca shembuj jepen në Tabelën 1.

Shqip	Zbërthimi	Latinisht	Anglisht
Pjellar	Pjell <b>ar</b>	Facite ergo arabilis et	I produce <b>arable</b> land
Pjellarg	Pjell <b>ar-g</b>	Qui facit terram arabilem	He who produces <b>arable</b> land.
Arbëra	<b>Ar</b> bëra	Ego feci terram arabilem	I made <b>arable</b> land.
Arbana	Ar bana	Ego feci terram arabilem	I made arable land.
Arbër Arbëresh	/ Ar bër [ës]	Qui facit terram arabilem	He who makes arable land.
Arbërës	Ar bër ës	Illi qui faciam terram arabilem	They who make arable land.
Arbëria	Ar bër ia	Dominium Arbëreshes, qui agricolae terram	The dominion of Arbëreshes, of land farmers.
Tokare	Tok(ë) <b>ar e</b>	<b>Arabilis</b>	<b>Arable</b> land
Gadishull	Gati ishull	Paene insula	Almost an island
Humbner(ë)	Humb në er(ë)	Evanescet in aere / ventum [cadit in abyssum irent]	Disappear in air/wind [falling in the abyss].
Illir	I lir/lirë	Liberi	Free
Iliri	I liri	Liberus	The free (mashk.)
Elira	E lira	Libera	The free (fem.)
Saimir	Sa i mir(ë)	Quam bonum	How good (mashk.)
Samir	Sa mir(ë)	Quam honestus	How well

Tabela 1. Shembuj të shprehjeve fjalore në gjuhën shqipe.

## 7. Gërmimi në len...gjuhë

Vetia e Shqipes (*Speech*, ang.) për të patur fjalë që në vetvete janë pjesë fjalie ose shprehje me kuptim të qartë e të plotë ka bërë që ajo të mbetet e pandryshuar në jetë të jetëve. Domethënë, mund të zhduken libra e shkrime në shqip por e folura e trashëguar dhe fjalët apo shprehjet e mbartura në len...gjuhët e tjera mjaftojnë për të rilindur ose rigjallëruar shqipen e plotë.

Fjalët apo shprehjet në shqip ndeshen në të tjerat len...gjuhë në të paktën në kontinentin europian dhe pellgun mesdhetar edhe në shkrime edhe në emërtime vendesh. Prania e shprehjeve shqip në formën e fjalëve në vendet dhe në të tjerat len...gjuhë vërteton se pjesët e gjuhës shqipe:

(1) Janë lënë të harruara pa u mbuluar përgjatë historisë, dhe ashtu janë ruajtur në origjinal. Rastet e shqyrtuara më poshtë si emërtime vendesh e pohojnë këtë gjë.

(2) Ose janë marrë çdoherë në përdorim për shkak të përmbajtjes së saktë të tyre.

(3) Ose janë marrë në përdorim duke u ndryshuar porse çdoherë fillesa shqipe iu është ruajtur.

(4) Ose, edhe nëse janë marrë në përdorim rastësisht nga të tjerat len...gjuhë të mëvonshme, ajo gjë vërteton praninë shumë më të hershme të gjuhës shqipe dhe një qytetërimi udhëheqës shumë të zhvilluar që fliste Shqip (*Speech*, ang.), domethënë Gjuhën Hyjnore.

Gjuha shqipe e tanishme ka në përdorim fjalë jo-shqipe të ngecura rastësisht ose me forcë nga pushtuesit përgjatë 2000 vjetëve të shkuara. E megjithatë, gjuha shqipe nuk ka ndryshuar sepse ajo i përshtat ato fjalë në Albanisht. Prania e fjalëve dhe shprehjeve fjalore që lexohen shqip në len...gjuhët e kontinentit europian dhe pellgut mesdhetar, dhe përtej:

(1) Përjashtoj marrjen e shprehjeve fjalore shqipe nga tërë len...gjuhët sepse shqipfolësit nuk kanë qenë ardhacakë pushtues të të gjithëve.

(2) Vërteton se shqipfolësit kanë qenë vendas të paktën në kontinentin europian dhe atë mesdhetar, dhe të pranishëm tek shkollarët gjithmonë. Për shembull, bujqit e parë Tokarë (*Tochari*, lat., *Tocharian*, ang.) në shekujt XX p.e.s. – VIII e.s. në Rrafshnaltën Tarim në Kinën perëndimore qenë racë europiane. [12, 13] Përshkrimi i tyre që në shqip: Tok(ë) ar-ë. Lidhja e tanishme me Tokarët është popullata Hunzake, e cila jeton në Luginën e Hundëzës/Hunzës, në Pakistan, pranë Rrafshnaltës Tarim. Si racë, ajo popullatë është europiane. Në kulturë, ajo ngjason më shqiptarët. Gjuha e tyre ka ruajtur shumë fjalë, fjali të shkurta dhe shprehje fjalore të Shqipes. [14-16]

(3) Tregon se ka patur një qytetërim të zhvilluar më të hershëm Shqip nga ku janë marrë fjalët e duhura për të hartuar len...gjuhët.

(4) Vërteton se kalimi nga Shqipja (*The Speech*, ang.) në të tjerat len...gjuhë ka pas ruajtur rrënjët gramatikore duke i mbartur të ngrira fjalët dhe shprehjet fjalore nga Shqipja. Kjo gjë sqaron edhe përputhshmërinë themelore të fjalëve Shqip (*Speech*, ang.) me ato në anglisht, dhënë në Tabelën 2.

Nr.	Gërma	Fjala Ang.	Fjala Shqip	Latinisht	Bizantine ose Greke
1	A	Uncle	Ungj	Patruus	Thios
2	B	Bull	Bull	Taurus	Tavros
3	C	Its	I tij / saj	Eius	Tou
4	Ç	Chick	Çikë	Puella	Kopella
5	D	Door	Der(ë)	Ostium	Thira
6	DH	That	Atë	Quod	Afto
7	E	Eight	Tet(ë)	Octo	Okto
8	Ë	Per	Për	Per	Ja
9	F	Flock	Flok	Gregem	Mali
10	G	Gurgle	Gurgulloj	Singulto	Kelaryzo
11	GJ	Legion	Legjon	Legio	Legeonas

PËRJETËSIA E GJUHËS SHQIPE QË NGA FILLIMI

12	H	Hunger	Hangër	Fames	Pina
13	I	Languish	Lëngo	Aegroto	Eksastheno
14	J	I am	Iam	Ego sum	Ime
15	K	Dark	Dark(ë)	Tenebrosi	Vradhi
16	L	Light	I leht(ë)	Levis	Elafros
17	LL	Pull	Tërheq	Attrahendam	Elko
18	M	Major	Madhor	Major	Mizon
19	N	Night	Nat(ë)	Nocte	Nihta
20	NJ	Onion	Qep(ë)	Cepa	Kremidhi
21	O	Copy	Cop(ë)	Exemplum	Antigrafo
22	P	Plough	Plug	Aratrum	Arotro
23	Q	Stockyard	Vath(ë)	Stabulatio	Stani
24	R	Desire	Dëshir(ë)	Cupiditas	Thelisi
25	RR	Narrow	I ngusht(ë)	Angusta	Stenos
26	S	Super	Sipër	Eximius	Yper
27	SH	Shawl	Shall	Palliolum	Salli
28	T	Trunk	Trung	Truncus	Kucuro
29	TH	Three	Tre	Tres	Tria
30	U	You	Ju	Vos	Esis
31	V	Vine	Ven(ë)	Vinum	Inos
32	X	Adze	Sqepar	Tondeo	Skepari
33	XH	Jacket	Xhaket(ë)	Paenulam	Sakaki
34	Y	Étude (fre.)	Studim	Stude	Spudi
35	Z	Zeal	Zell	Zelus	Zillos
36	ZH	Vision	Fushpamësi	Visio	Orama

Tabela 2. Fjalët e krahasuara për çdo gërmë të Abecesë Shqip.

## 8. Mbartur tek librat e shenjtë

Dhiata e parë është Dhiata Hebraike e quajtur *Tanakh* në hebraisht dhe shkrimet e lashta fetare janë përmbledhur në 24 libra. Ajo ndahet në tre pjesë: *Torah* (5 libra), *Nevi'im* (8 libra), *Ketuvim* (11 libra). Dhiatë e Vjetër quhet pjesa e parë e Dhiatave të krishtera, e shkruar duke u mbështetur në Dhiatën Hebraike. [17,18]

Libri i parë në *Torah* quhet “Në Fillim” (*Bereishit*, hebr.) dhe në Dhiatën e Vjetër ai quhet “Zanafilla” (*Genesis*, ang.). Vetë fjala *Bereishit* tingëllon shqip: “Bërë ishit / sit”, sepse në këtë libër të



parë jepet krijimi i natyrës dhe jetës në fillim. [19] Kalendar i hebraik e fillon krijimin e jetës në vitin 3761 p.e.s. Në këtë libër shkruhet si më poshtë [20, 21]:

Zanafilla 1:1 - Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën.

Zanafilla 6:4 - Kishte nëfillimë mbi tokë në ato kohë, madje edhe më vonë, kur bijtë e Perëndisë iu afruan bijave të njerëzve dhe këto u lindën atyre fëmijë. Ata janë heronjtë që jetuan në kohët e lashtësisë, janë njerëzit e famshëm të atyre kohëve.

Zanafilla 11:1 - Dhe tërë toka fliste të njëjtën gjuhë dhe përdorte të njëjtat fjalë.

Zanafilla 11:6 - Dhe Zoti tha: Ja, ata janë një popull i vetëm dhe kanë të gjithë të njëjtën gjuhë; dhe kjo është ajo që ata filluan të bëjnë; tani asgjë nuk ka për t'i penguar ata të përfundojnë atë që kanë ndërmend të bëjnë.

Libri i katërt në *Torah* titullohet “Në Shkretëtirë” (*Bamidbar*, hebr.) dhe “Numrat” në Dhiatën e Vjetër. Në të shkruhet [20, 21]:

Numrat 13:33 - Dhe aty pamë nëfillimët (pasardhësit e Anakut rrjedhin nga nëfillimët), përballë të cilëve na dukej se ishim karkaleca, dhe kështu duhet t'u dukeshim atyre.

Duke e analizuar nga këndvështrimi gramatik, morfologjik, sintaksor, fonologjik, fonetik, semantik, pragmatik e antropologjik, fjala “Nëfillimët” për nga vendndodhjet e përdorimi i saj është në mënyrë të pastër shprehje shqipe. Fjala "nëfillimët" është në fillim të rrëfimit në librin e parë të shkruar për Zanafillën e Origjinës, është në fillim të fillimit të Krijimit. Ajo ripërmendet edhe në librin e katërt. Ajo fjalë është aty ku e kur përshkruhen njerëzit në fillim të krijimit të jetës mbi Tokë, njerëzit e fillimit, domethënë nëfillimët. Kudo flitej e njëjta gjuhë në fillim, gjuha e nëfillimëve, domethënë shqip (*speech*, ang.).

Titujt e pjesës së dytë e të tretë të Dhiatës Hebraike përkthehen nga hebraishtja *Nevi'im* = Profetët dhe *Ketuvim* = Shkrimet. Të dy këto tituj tingëllojnë shqip sepse ato lexohen shqip dhe japin kuptim të saktë për çfarë përfaqësojnë si tituj e përmbajtje në hebraisht. Tetë librat *Nevi'im* janë librat e (Ne!) profetëve, thëniet e të cilëve vijnë (Ku?) në shkrimet e tyre.

*Nevi'im* = Ne vim = Ne vijmë = Ne [profetët] vijmë = *We [the prophets] come* (ang.).

*Ketuvim* = Këtu vim = Këtu vijmë = Këtu [në këto shkrime] vijmë = *Here [in these writings] we come* (ang.).

Libri i Mormonit është një tekst i shenjtë i Lëvizjes së Ditës së Shenjtë të Mëvonshme i ngjashëm me Dhiatën dhe botuar për herë të parë në Mars 1830 në ShBA. Në hyrjen e librit flitet për dy gurë të shenjtë të quajtur **Urim** dhe **Thummim** të ngjitur në gjoksoren e parashikuesve të lashtë. [22] Fjalët Urim dhe Thummim ndeshen shtatë herë në Dhiatën e Vjetër. [23]

Shpjegim apo kuptim të saktë për këto dy fjalë nga ata që nuk janë shqiptarë nuk ka. Ndërsa, nga këndvështrimi gramatik, morfologjik, sintaksor, fonologjik, fonetik, semantik, pragmatik e antropologjik këto janë fjalë të pastra në shqip: Urim dhe Thummim/Thumim/Thumbim. Çdo shqiptar i lexon dhe kupton menjëherë këto dy fjalë dhe buzëqesh. Sepse, jeta ka kuptim të vështrohet si urim dhe thumbim, si kënaqësi dhe moskënaqësi, si pëlqim dhe mospëlqim.

Të flasësh shqip domethënë të flasësh gjuhën e shenjtë, Shqipen e Shenjtë (*Holy Speech*, ang.), Frymën e Shenjtë, Fjalën e Shenjtë, Shqipen Hyjnore, të Folmen e Parë, sepse e para ishte fjala pastaj filloi jeta.

## 9. Mbartur në emërtimet e vendeve

Disa shembuj për shprehjet shqip të ruajtura si emërtime vendesh jepen më poshtë. Të para nga këndvështrimi gramatik, morfologjik, sintaksor, fonologjik, fonetik, semantik, pragmatik e antropologjik këto emërtime janë shprehje fjalore të qarta në shqip (*speech*, ang.). Këto shembuj janë domethënës sepse vërtetohen pikërisht prej vetisë gjeografike natyrore të atij vendi. Kjo gjë shkon përtej origjinës apo rrënjëve gjuhësore të fjalëve (*etymology*, ang.) dhe emërtimeve të vendeve (*toponymy*, ang.). Shembujt më poshtë kanë të bëjnë pikërisht me mbartjen e shprehjeve fjalore të gjuhës shqipe në vendet e mbuluara nga len...gjuhët.

**Mar Mediterraneo** (ita.) – Deti Mesdhe – Deti Mes dhe – Në libra jepen emërtime historike të ndryshme për të dhe se emri i tanishëm është ndeshur në një dokument të një shkollari spanjoll të shekullit VI. [24] Siç mund të shihet nga shumë lart mbi Tokë, Deti Mes-dhe domethënë fjalë për fjalë në shqip Deti në Mes të Dheut.

**Aigaío Pélagos** (biz.) - Ege Denizi (turk.) - Mar Egeo (ita.) – Deti Egje – Ky është deti shumëishullor midis Greqisë dhe Turqisë. Në libra, origjinës dhe kuptimit të emrit të tij i mveshin një përrallë të pakuptimtë lashtësie. [25] Meqenëse ky det është pjesë e Detit Mesdhe të madh, vendasit ishullorë dhe kontinentalë, domethënë arbanasit, arbanitët (arvanitët, biz.), e quanin Deti Mesogjë. Ky emër është shprehje fjalore në Shqip që përshkruan vetinë e atij deti, domethënë cilëson Detin Meso-Gjë, detin që është në mes. Dhe vetvetiu emri i detit në shqipen vendase ngeli Deti Egje ndërkohë që më vonë mori forma ndryshe në të tjerat len...gjuhë.

**Malta** - Maltha - Mal tha - Malta është ishull-shtet në Detin Mesdhe. Malta është pikërisht një ishull shkëmbor malor i thatë, ku nuk ka lumenj dhe liqene të përhershëm. [26] Maltha ose Mali i Thatë është një emërtim i zakonshëm në trojet shqiptare.

**Gibraltar** (ang.) - Gjibrjllthari - Gji brryl thari - Gjibraltari është qytet-shtet britanik përtej deteve, në kufi me Spanjën; cepi në anën lindore të gjiut përkatës. E parë nga shumë lart mbi Tokë, forma e cepit i ngjan brryllit të përthyer, ku pjesa e brendshme është porti i Gjibrjlltharit. Dhe pothuaj tërë cepi mbulohet nga Shkëmbi i Gjibrjlltharit, i cili është një mal gëlqeror i thatë; më saktë, i tharë sepse është gëlqeror. [27] Pra, ai që njihet si *Bay of Gibraltar* (ang.) ose *Bahía de Algeciras* (spa.) është pikërisht Gji-Brryl-Thari.

**Lombardia** (ita.) - Lumbardhia – Lum bardhi-a - Lombardia është provinca veri-perëndimore e Italisë me kryeqendër Milanon. [28] Lumbardh ose Lumë i Bardhë ose I Bardhi ose Bardhar janë emra të zakonshëm në trojet shqiptare. Lum-bardhi-a është emër qartësisht shqip për rajonin e madh ku kalon i quajturi në mënyrë natyrale Lumi i Bardhë. Në fakt, lumi i madh në Italinë e veriut që përvijon kufirin jugor të provincës Lombardia quhet Lumi Po, që në italisht nuk shpjegohet por në shqip lexohet qartas Po (*Yes*, ang.). Lumbardhi është lumë pranë maleve të larta apo Alpeve. Si i tillë ai është lumë që mbledh ujin e borës së bardhë, prandaj quhet Lum-bardhi.

**Trieste** - Triësthtë - Tri është - Trieste është qytet në breg të Detit Adriatik në veriun e Italisë. Në thelb, qyteti i Triestes është i ndërtuar mbi tre kodra të mëdha. [29]

**Etruria** – E truri-a – Tru-ri-a – Etruria ishte në shekujt IX – VI p.e.s. një rajon mjaft i zhvilluar në qendrën dhe pjesën e sipërme perëndimore të gadishullit Apenin. Kultura romake mbiu prej kulturës etruske. Periudha etruske përfundoi me themelimin e Republikës Romake në vitin 509 p.e.s. [30]

Ndërsa në të tjerat len...gjuhë ky emër nuk ka shpjegim, në shqip (*speech*, ang.) ky emër njërrrokësh është lehtas i qartë: Tru (*Brain*, ang.). Po në shqip, banorët e atij rajoni quhen E-tru-skë dhe në përdorim si mbiemër gjuhësor fjala është E-tru-ske. Në mes të atij rajoni kalonte/kalon lumi Albania (*Albegna*, Ita.).

Emri “Truri” (*The Brain*, ang) është sipas të folmes shqipe të Shqipërisë jugore. Sipas të folmës veriore ai është “Truni”. Me kalimin e shekujve dhe si përshtatje në përdorim Etruskët e të shkuarës u quajtën Tuskë/Toskë (*Tuscī*, lat.) dhe rajoni i tyre Toskanë (*Toscana*, ita., *Tuscany*, ang.). Ndërkohë në Shqip rajoni i Shqipërisë jugut quhet akoma Toskëri dhe banorët Toskë, kurse rajoni i Shqipërisë veriut quhet Gegëri dhe banorët Gegë. Ai “Tru” rilindi në Firenze, Toskanë, në shekullin XIV, kulmoi në

shekullin XV, i dha dritën Rilindjes kulturore italiane e cila më pas i dha dritë Rilindjes europiane në shekujt XV-XVI.

**Via Egnatia** (lat.) – Via/Vija Enjatia – Via/Vija E-njati-a – Rruga Enjatia qe një rrugë e famshme e ndërtuar nga romakët në shekullin II p.e.s. Ajo fillonte në Durrësin e Ilirisë, vazhdonte nëpër luginën e lumit Shkumbin kalonte Maqedoninë e Thrakën, dhe arrinte në Bizant (Stambolli i sotëm). [31] “GN” në latinisht ose italisht shqiptohet “NJ” si në shqip. Kjo domethënë se Egnatia/Enjatia është një shprehje fjalore e pastër në shqip e cila ka kuptimin e një emri në gjuhësi. Ndërsa “E njati” dëftën veprimin zgjatues ([*He*] *reached out*, ang.), shprehja fjalore “E njati-a” (*The reaching out*, ang.) është emër i shquar në gjuhësi. Kuptimi është i saktë sepse Via *Egnatia/Enjatia* ishte një zgjatim në anën lindore të Detit Adriatik të Rrugës *Appia* që lidhte Romën me Brindizin.

Pranë fjalës Egnatia/Enjatia edhe fjala në latinisht “Via” (*The Road*, ang.) është në shqip sepse rrënja e saj “Vi” është në shqip: Vi (*Line*, ang.) dhe Via/Vija (*The Line*, ang.). Mbi dheun e tokës Via (lat.) është një rrugë (Road, ang.). Shumë lart nga sipër, Via (lat.) ose Road (ang.) është një Vi në shqip (Line, ang.). Via *Egnatia/Enjatia* është akoma dhe emri i saj shihet i gdhendur mbi gurë. Ky rast është një vërtetim se Shqipja (*The Speech*, ang.) ishte në përdorim dhe shkollarët shqipfolës ishin të pranishëm në ato kohëra.

**Íonio Pélagos** (biz.) - Mar Ionio (ita.) - Deti Ion - Deti Ion/Ionë/Jonë - Ky është deti që përkufizohet nga Shqipëria e jugut, Greqia perëndimore dhe Italia e jugut. Në Greqi, emrit Ion ose nuk ia dinë zanafillën ose i mveshin një përrallë me histori të pakuptimtë lashtësie. [32] Por në shqip ai është në fakt përemër pronor: jonë, i jonë. Pra emri i saktë i tij është Deti Ionë/Jonë (*Our Sea*, ang.)

**Mer Tyrrhénienne** (fr.) - Mar Tirreno (ita.) - Deti Tiren/Tyren – Deti Tire-n / Tyre-n – Ky është deti në pjesën perëndimore të poshtme të Italisë dhe kufizohet edhe nga Siçilia, Sardenia dhe Korsika. Në libra, origjinën e emrit të tij e nxjerrin nga një përrallë lashtësie për një princ Tyrrhenus që bashkë me ardhacakët e tij nga Lidia (Turqia e sotme) u vendosën tokën e Etruskëve. [33]

Në shqip, ky emërtim lexohet dhe kuptohet lehtas drejtpërsëdrejti Deti i Tire ose Deti Tiren sipas të folurës jugore shqiptare apo Deri i Tyre ose Deti Tyren sipas të folurës veriore shqiptare. Emërtimet në shqip Deti Ion/Ionë/Jonë (*Our Sea*, ang.) dhe Deti Tyren/Tiren (*Their Sea*, ang.) vërtetojnë dhe i japin kuptim plotësues njëri tjetrit, sepse njëri det është në anën lindore dhe tjetri në anën perëndimore të Italisë së poshtme. Për më shumë, gjuha rrënjë e popullit të Sardenjës quhet Arvareshu dhe është qartësisht Shqip. [34-36]

**Étretat** - Etrétat - E tretat - Étretat është fshat bregdetar, pjesë e rajonit *Seine-Maritime* në Normandi, në veri-perëndim të Francës. Étretat, si pjesë e brigjeve të larta shkëmbore, mirë-njihet për tre harqe të mëdhenj shkëmbore të ngulur në oqean. [37] Për vendasit Étretat nuk ka ndonjë kuptim. Në Shqip, Étretat është pikërisht vendi i të tre harqeve, vendi i të tretave, E tretat.

**Baltic Sea** (ang.) - Deti Baltik - Deti Balt-ik - Ky është deti që përkufizohet nga Gjermania, Polonia, Lituania, Letonia, Estonia, Finlanda e Suedia. Brigjet këtij deti janë me baltë e llucë (*Mud*, ang.), moçalore e jo shkëmbore. [38, 39] Prandaj, mbiemri gjuhësor “Baltik” shpreh në shqip pikërisht vetinë natyrore të tokave të laguna për brigjet të këtij deti.

**Danube River** (ang.) – Lumi Danub – I Shtrimi – Ky lum buron në Gjermani dhe duke mbledhur sasi prurje shumë të mëdha ujrash rrjedh shtruar drejt juglindjes për 2850 km deri në Detin e Zi. Ai është i lundrueshëm për 2415 km dhe si i tillë ka qenë rrugë tregtare që në kohët e lashta.

Ai paraqitet me emrin Ister mbi një hartë të përcjellur si e vitit 450 p.e.s. me autor një persian të quajtur Herodoti i Halikarnasit (484 – 425 p.e.s.); vendndodhja: Azia e Vogël e sotme. Po me këtë emër paraqitet edhe mbi një hartë të përcjellur si e vitit 220 p.e.s. me autor një afrikan të quajtur Eratosteni i Sirenës (276 – 195 p.e.s.); vendndodhja: Libia e sotme. I njëjti emër u ruajt edhe në hartat e perandorisë romake. Për shembull, ky lumë përbënte kufirin e sipërm të Prefekturës së Ilirisë mbi një hartë të vitit 395 e.s. Emri i vonshëm Danub paraqitet i përshtatur në len...gjuhët e ndryshme. Ka

shumë hamendësime që duke marrë parasysh përbërësit gjeografikë dhe historikë përpiqen t'i gjejnë rrënjën dhe kuptimin emrave të këtij lumi. [40]

Meqenëse tipari dallues i këtij lumi është rrjedhja e shtruar, në Shqip thuhet: “Ky lum rrjedh shtruar”. Dhe prandaj, ai është quajtur që nga fillimi “I Shtrimi”, lumi që rrjedh shtruar.

## 10. Përfundim

Shqipja (*The Speech*, ang.) ka mbirë e para në hapësirën Euro-Mesdhetare. Shqipja nëse do ishte e re do kishte ose do ia kishin caktuar një datë fillimi. Ajo është aq e vjetër saqë historia e shkruar euro-mesdhetare pa dashje edhe e dallon edhe e vërteton se gjuha shqipe është më e vjetra. Meqenëse edhe gjuha trashëgohet, Shqipja rilindi e plotë pas shekujve të Errësirës.

Shqipja (*The Speech*, ang.) mund të zbërthejë shkrimet e shumta të lashta të skalitura mbi gurë e poçe. Të tilla si, ato të mëtuara së përfaqësojnë len...gjuhët “e lashta greke” apo të qytetërimit Shumer 4500-1900 p.e.s.

U provua se emërtimet Nëfillimë (*Nephilim*, ang.), Pjellargë, Tokarë, Arbërës, Arbëreshë, Arbanas dhe Arvareshu janë shprehje fjalore në Shqip (*Speech*, ang.). Të gjithë këta emra i përkasin popullit të fillimit.

Lehtësisht u provua se shprehjet fjalore në Shqip janë edhe pjesë e vet Shqipes edhe të mbartura në len...gjuhët. Për shembull, Dhjatat e Shenjta përmbajnë shprehje fjalore në Shqip. Për sa i përket Dhjatave të Shenjta, çështja nuk është se librat fetarë nuk mund të përdoren si burim shkencor, gjë që është e pranueshme. Sepse ajo që ka rëndësi është se çfar mbartin ato libra të shumë të vjetër. Dhe kjo domethënë se më shumë dituni mund të nxirret për kohët që ata libra iu përkasin.

Shprehjet fjalore në Shqip që janë ruajtur kudo në emërtimet e vendeve madhështore të mirënjohura vërtetojnë vetveten sepse ata shprehin saktësisht tiparet e vendeve përkatëse.

Mbi të gjithat e thëna më sipër, është pak të vihet në pikëpyetje nëse “Ilirët” e Gadishullit Ilirik ishin apo nuk ishin “I Lirë” apo “Të Lirë” (*The Free* ose *Free*, ang.). [41] Veçan nga kjo, shumë më të thella janë pyetjet se cilët i quajtën ato “I-Lirë”, cilët e mbartën dhe si deri në ditët e sotme këtë emër që është mbiemër cilësor, dhe çfar mbart ky emër. Shqipen e Shenjtë (*The Holy Speech*, ang.), Gjuhën Hyjnore (*The Heavenly Tongue*, ang.)

## 11. Mirënjohje

Është mirësi të kujtohen shkëmbimet e çmuara të mendimeve me të nderuarin Robert Elsie, drita e të cilit u shua më 2 Tetor 2017.

## 12. Burime të përdorura

1. Logical Truth. <https://plato.stanford.edu/entries/logical-truth/> (20.02.2020)
2. Gottfried Wilhelm Leibniz. <http://plato.stanford.edu/entries/leibniz/> (20.02.2020)
3. Fabius Planciades Fulgentius. [https://en.wikipedia.org/wiki/Fabius\\_Planciades\\_Fulgentius](https://en.wikipedia.org/wiki/Fabius_Planciades_Fulgentius) (20.02.2020)
4. Natalis Comes. [https://en.wikipedia.org/wiki/Natalis\\_Comes](https://en.wikipedia.org/wiki/Natalis_Comes) (20.02.2020)
5. Fahri Xharra, Roma fliste Shqip, Lena, Prishtinë, 2019
6. East India Company. [https://en.wikipedia.org/wiki/East\\_India\\_Company](https://en.wikipedia.org/wiki/East_India_Company) (20.02.2020)
7. Michael Kimmelman, Elgin Marble Argument in a New Light, New York Times, 23 June 2009
8. Roman Province. [https://en.wikipedia.org/wiki/Roman\\_province](https://en.wikipedia.org/wiki/Roman_province) (20.02.2020)
9. Hellas (theme). [https://en.wikipedia.org/wiki/Hellas\\_\(theme\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Hellas_(theme)) (20.02.2020)
10. Luigi Luca Cavalli-Sforza, Genes, Peoples and Languages, North Point Press, New York, 2000
11. Flower of Life Meaning, Origin, Application, Effect. <http://flower-of-life.net/> (20.02.2020)

12. [www.gerdcarling.se/2018/07/11/the-tocharians,-the-mysterious-people-that-travelled-more-than-4000-km-and-ended-up-in-a-desert-40064107](http://www.gerdcarling.se/2018/07/11/the-tocharians,-the-mysterious-people-that-travelled-more-than-4000-km-and-ended-up-in-a-desert-40064107) (10.01.2020)
13. Tocharians. <https://en.wikipedia.org/wiki/Tocharians> (20.02.2020)
14. Jay M. Hoffman, Hunza: Fifteen secrets of the healthiest and oldest living people, Professional Press Publishing Association, 5th Ed., Valley Center, 1985
15. Etienne Tiffou, Hunza Proverbs, University of Calgary Press, Calgary, 1993
16. Saimir Lolja, Hundëza dhe Hunzakët jetëgjatë, g. Panorama, 30 Tetor 2003
17. Hebrew Bible. [https://en.wikipedia.org/wiki/Hebrew\\_Bible](https://en.wikipedia.org/wiki/Hebrew_Bible) (20.02.2020)
18. Old Testament. [https://en.wikipedia.org/wiki/Old\\_Testament](https://en.wikipedia.org/wiki/Old_Testament) (20.02.2020)
19. Book of Genesis. [https://en.wikipedia.org/wiki/Book\\_of\\_Genesis](https://en.wikipedia.org/wiki/Book_of_Genesis) (20.02.2020)
20. English Standard Version Bible. <https://biblehub.com/> (20.02.2020)
21. Orthodox Jewish Bible. <https://biblehub.com/> (20.02.2020)
22. The Book of Mormon, LDS Church internet ed., Salt Lake City, 2013
23. Urim and Thummim (Latter Day Saints).  
[https://en.wikipedia.org/wiki/Urim\\_and\\_Thummim\\_\(Latter\\_Day\\_Saints\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Urim_and_Thummim_(Latter_Day_Saints)) (20.02.2020)
24. Mediterranean Sea. [https://en.wikipedia.org/wiki/Mediterranean\\_Sea](https://en.wikipedia.org/wiki/Mediterranean_Sea) (20.02.2020)
25. Aegean Sea. [https://en.wikipedia.org/wiki/Aegean\\_Sea](https://en.wikipedia.org/wiki/Aegean_Sea) (20.02.2020)
26. Malta. <https://en.wikipedia.org/wiki/Malta> (20.02.2020)
27. Gibraltar. <https://en.wikipedia.org/wiki/Gibraltar> (20.02.2020)
28. Lombardy. <https://en.wikipedia.org/wiki/Lombardy> (20.02.2020)
29. Trieste. <https://en.wikipedia.org/wiki/Trieste> (20.02.2020)
30. Etruria. <https://en.wikipedia.org/wiki/Etruria> (20.02.2020)
31. Via Egnatia. [https://en.wikipedia.org/wiki/Via\\_Egnatia](https://en.wikipedia.org/wiki/Via_Egnatia) (20.02.2020)
32. Georgios Babiniotis, Lexiko tis Neollinikis Glossas (Dictionary of Modern Greek Language), Kentro Lexikologias, Athens, 2012
33. Tyrrhenian Sea. [https://en.wikipedia.org/wiki/Tyrrhenian\\_Sea](https://en.wikipedia.org/wiki/Tyrrhenian_Sea) (20.02.2020)
34. Salvatore B. Mele, Arvareshu: Gjuha proto-sarde ilirike, 2013. [www.voal-online.ch/index.php?mod=article&cat=SHQIPTAR%C3%8BT&article=36153](http://www.voal-online.ch/index.php?mod=article&cat=SHQIPTAR%C3%8BT&article=36153) (20.02.2020)
35. Salvatore B. Mele, Arvareshu: La Lingua Protosarda Ilirica Pelasgica e Etrusca, Sardinia: Logo Sardinia E-Book, 2015
36. Salvatore B. Mele, Sardegna: Arvareshu, una lingua sorella dell'Albanese, 2019.  
[www.youtube.com/watch?v=Z6I7a15R3Ag&feature=youtu.be](http://www.youtube.com/watch?v=Z6I7a15R3Ag&feature=youtu.be) (20.02.2020)
37. Étretat. <https://en.wikipedia.org/wiki/%C3%89tretat> (20.02.2020)
38. Baltic Sea. [https://en.wikipedia.org/wiki/Baltic\\_Sea](https://en.wikipedia.org/wiki/Baltic_Sea) (20.02.2020)
39. James S. Aber, Bogs and Mires of the Baltic Region with Examples from Estonia.  
<http://academic.emporia.edu/aberjame/wetland/baltic/baltic.htm> (20.02.2020)
40. Danube. <https://en.wikipedia.org/wiki/Danube> (20.02.2020)
41. John J. Wilkes, The Illyrians, Blackwell, Massachusetts, 1992